

## **Bashkia në proceset e Integrimit Evropian**

Procesi i integrimit evropian është sfida dhe prioriteti kryesor për Shqipërinë, ku pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe qeverisja vendore.

Mjetet me të cilin BE mbështet Shqipërinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit janë programet e BE-së. Përfitimi i fondeve të BE-së në nivel vendor varet edhe nga angazhimi i njësive vendore.

Prandaj është thelbësore ngritja e kapaciteteve në nivel vendor për tu ballafaquar me sfidat që procesi i integrimit evropian sjell.

Mirjeta Shehaj

Koordinatorë për Çështjet e BE-së në Bashkinë Mallakastër

email : mishehaj@bashkiamallakastër.gov.al

### **Orari i Punës i Administratës së Bashkisë:**

E Hënë – E Premte

08:00 – 16:00

### **Ngritja e Këndit të BE-së Mallakastër:**

Në kuadër të projektit “Bashkitë për në Evropë”, financuar nga Bashkimi Evropian, është ngritur dhe funksionon Këndi i BE-së pranë Bashkisë Mallakastër.

Këndi i BE-së, në 61 bashkitë në vend do të shërbejë si pikë ndërlidhjeje me BE-në për të informuar qytetarët dhe punonjësit e bashkisë mbi BE-në, politikat dhe programet e saj.

### **Funksioni i këndit të BE-së:**

Koordinim të brendshëm për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, trainim për politikatat e BE-së dhe aksesin në fondet IPA.

Kanal komunikimi ndërmjet komunitetit, Qeverisë dhe BE-së për çështjet e BE-së në interes të komunitetit.

Një qendër informimi e bashkisë ku publiku të mund të marrë informacion për çështjet, Programet e BE-së, etj

Organizim eventesh për çështjet e BE-së/Ditët e BE-së, Ditët Kombëtare të Vendeve Anëtare, etj.

Për më shumë informacion për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian klikoni më poshtë:

### **Marrëdhëniet e Shqipëri-BE**

Marrëdhëniet e vendit tonë me Bashkimin Evropian, bazuar në objektivin kombëtar të integrimit në BE, janë strategjike dhe prioritare të politikës sonë të jashtme. Interesi parësor i Shqipërisë në raport me BE-në është anëtarësimi në BE në të ardhmen.

<http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>

### **Negociatat për anëtarësim**

<http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/negociatat/>

### **Bashkia në proçeset e integrimit evropian**

Bashkia Mallakastër në kuadër të proçesit të vlerësimit të performancës në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme realizon proçesin e përvitshëm të vlerësimit të performancës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve në kuadër të kritereve politike, ekonomike dhe standarteve që lidhen me proçeset e qeverisjes vendore në lidhje me integrimin evropian, si dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit.

<https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/main.aspx>